



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Nr. 1751 prot.

Elbasan, më 12 . 12 .2017

U R D H Ë R

Nr. 285 datë 12 . 12 .2017

Për miratimin e Rregullores
"Për

Procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e
konfidencialitetit"

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Statutit dhe Rregullores së UE-së,

U R D H Ë R O J

1. Miratimin e rregullores: "Për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit".
2. Të njihen të gjithë strukturat e UE-së me këtë Rregullore.
3. Të bëhet shpallja në Web-in e UE-së e kësaj Rregulloreje.
4. Ngarkohet: Administratori, Drejtoria koordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë dhe Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkivit për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr. Skender TOPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Rregullore
"Për
procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes e
konfidencialitetit"

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimit të mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit nga strukturat e Universitetit të Elbasanit, në zbatim të Ligjit 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

Neni 2
Baza Ligjore

Përcaktimi i procedurave të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit mbështeten në legjislacionin dhe akte ligjore në fuqi.

Neni 3
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë si procedurat e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit

Neni 4
Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
- "Hakmarrja"** është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim i kryer nga organizata me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interes e ligjshmëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
 - "I sinjalizuar"** janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
 - "ILDKPKI"** është Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
 - "Informacion publik"** ka të njëjtën kuptim të dhënë për të drejtën e informimit.
 - "Korrupsion"** është çdo veprim apo mosveprim i kundërligjshëm, sipas legjislacionit penal në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimit të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave

ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimit të paligjshëm të interesave si dhe çdo akt tjetër i ngjashëm me to.

- f) **"Mbrojtje"** është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të Ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"
- g) **"Njësia përgjegjëse"** është organ i posaçëm i caktuar brenda UE-së dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"
- h) **"Sinjalizim"** është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit te njësia përgjegjëse e UE-së ose ILDKPKI-së për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në UE.
- i) **"Sinjalizim i brendshëm"** është raportimi i kryer nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse në UE.
- j) **"Sinjalizim i jashtëm"** është raportimi i kryer nga sinjalizuesi pranë ILDKPKI-së.
- k) **"Sinjalizues"** është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë UE-së, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
- l) **"Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni"** është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjnë korrupsion.

Neni 5

Parimet e veprimtarisë

Për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Universiteti i Elbasanit, bazohet në këto parime:

- ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të sinjalizuesit dhe sekretit shtetëror nga autoriteti përgjegjës i UE -së;
- njohjen e identitetit të sinjalizuesit përveç rastit kur ky ligj lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
- sinjalizimin vullnetar të një praktike të dyshuar të korrupsionit;
- integritetin e paanshmërisë së njësisë përgjegjëse së UE-së gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- zbatimin e mekanizmave të efekshmëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të sinjalizuesit;
- procedure e hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU II

PROCEDURA E VEPRIMIT

Neni 6

Sinjalizimi

Çdo person, punonjës në Universitetin e Elbasanit, të cilët vihen në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë UE-së, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt, sipas rastit, tek njësia përgjegjëse pranë rektoratit të UE –së ose ILDKPKI-së.

Neni 7

Mirëbesimi i sinjalizuesit

1. Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit, të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas kriteve të parashikuara në Ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
2. Sinjalizuesi konsiderohet se ka vepruar në mirëbesim, nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se është duke sinjalizuar një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, si dhe:
 - a) nuk e dinte ose nuk kishte mundësi objektive për të ditur se informacioni i sinjalizuar nuk ishte i vërtetë ose i saktë edhe nëse më vonë rezulton se ka gabuar në lidhje me vërtetësinë ose saktësinë e tij, ose vërtetohet nga organet kompetente se nuk është kryer një vepër penale e korrupsionit;
 - b) sinjalizimi nuk kryhet në mënyrë abuzive, shpifëse ose sinjalizuesi nuk mashtron mbi informacionin e sinjalizuar.
3. Sinjalizuesi prezumohet të jetë në mirëbesim, derisa nuk provohet e kundërta nga Universiteti i Elbasanit.

Neni 8

Regjistrimi, forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve. Njësisë përgjegjëse në Universitetin e Elbasanit nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.
2. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para njësisë përgjegjëse në Universitetin e Elbasanit ose ILDKPKI dhe dokumentohet me shkrim prej tyre.
3. Sinjalizimi duhet të përmbajë të paktën:
 - a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - ç) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
 - d) Sinjalizimi mund të kryhet tek njësisë përgjegjëse mbrenda institucionit (*sinjalizim i brendshëm*)
 - dh) Sinjalizimi mund të kryhet tek ILDKPKI-ja, (*sinjalizim i jashtëm*) duke parashtruar shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
4. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga njësisë përgjegjëse e UE-së, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Në raste të tjera për sigurimin e anonimatit sinjalizuesit i jepen iniciale mbrotëse të identitetit të tij.
5. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas forms dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të dhëna mbrenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 9

Mosfillimi i hetimit administrative

Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve pranë rektoratit të UE-së nuk e fillon hetimin administrative kur:

- a) sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar sipas nenit 8, të kësaj rregulloreje dhe sinjalizuesi nuk i korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
- b) sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- c) kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

KREU III

STRUKTURAT E SHQYRTIMIT TË SINJALIZIMIT

Neni 10

Sinjalizimi i brendshëm dhe njësia përgjegjëse

1. Në Universitetin e Elbasanit, funksionon struktura e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve e cila vepron në zbatim të në zbatim të ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

2. Sinjalizimi i brendshëm në Universitetin e Elbasanit realizohet pranë njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet sipas Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Përfaqësuesit e kësaj njësie caktohen nga rektori sipas VKM 816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike në zbatim të Ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

Neni 11

Sinjalizimi i jashtëm tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

1. Sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek njësia përgjegjëse në UE ose tek ILDKPKI-ja. Sinjalizuesi e sinjalizon veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja në rastet kur:

a) njësia përgjegjëse në Universitetin e Elbasanit nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me Ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

b) ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse të UE-së ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;

c) ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit, sipas parimeve të këtij ligji;

ç) prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga UE-ja

2. Në rastet e përmendura çdo hetim i UE-së, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja.

Neni 12

Bashkëpunimi

Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit bashkëpunon me institucione të tjera dhe ILDKPKI –në për shkëmbim të dhënash, të plota dhe pa asnjë rezervë, me qëllim shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar duke zbatuar parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

KREU IV

PROCEDURA E HETIMIT ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT

Neni 13

Parimet e përgjithshme të hetimit administrativ nga UE-ja

Në kryerjen e funksioneve të saj, njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit duhet:

- a) të veprojë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizuesit;
- b) të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influence tjetër të padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave, sipas këtij ligji;
- c) të veprojë duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm dhe deklaron menjëherë tek rektori dhe Administratori konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrativ të një sinjalizimi;
- d) të veprojë duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- e) të veprojë duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë mbron të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi.

Neni 14

Procedura dhe afati i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në UE zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit heton administrativisht sinjalizimin duke e përfunduar atë sa më shpejt të jetë e mundur, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.

3. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të

mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethana të çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit gjatë periudhës së hetimit administrativ, shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

4. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve të UE-së.

5. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:

- a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
- b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
- c) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

6. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit duhet të vendosë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat e zotëruara prej saj.

7. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në UE është e detyruar t'i përgjigjet mbrenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

8. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

Neni 15

Provat në hetimin administrativ

1. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Në qoftë se lind nevoja për dokumentacion shtesë provues, ai do të merret me shkrim nga institucionet e tjera.

2. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit ka të drejtë të këqyrë sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.

3. Në raste të veçanta, Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në UE, vlerëson se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës, që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të rektorit.

4. Gjatë ushtrimit të detyrës, Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit, zbaton për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet aktkontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e UE-së dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në organizatat private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 16

Përfundimi i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit ka të drejtë të përfundojë hetimin administrativ nëse:
 - a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, UE-ja njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
 - b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 7 të kësaj rregulloreje;
2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJA E SINJALIZUESVE

Neni 17

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm ose të jashtëm, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit ruan në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë brenda ose jashtë UE-së, si dhe të mos e përdorë për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
3. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit, në komunikimet në lidhje me hetimin e sinjalizimit respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara.
4. Çdo person, i cili merr informacion konfidencial nga njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Universitetin e Elbasanit për qëllim të këtij ligji, ka të njëjtin detyrim për përpunimin e informacionit në mënyrë konfidenciale.

Neni 18

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të zbatimit të Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, konstatohet mosrespektim i legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave

personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI TË DREJTAT DHE MBROJTJA E SINJALIZUESVE

Neni 19

Të drejtat e sinjalizuesit

1. Të drejtat dhe interesat e sinjalizuesve mbrohen në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme.
2. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e:
 - a) konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, që përfshin, gjithashtu, mundësinë e sinjalizimit anonim të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni;
 - b) ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit;
 - c) mbrojtjes kundër hakmarrjes;
3. Të drejtat e sinjalizuesit garantohen, sipas Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” në këto raste:
 - a) gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;
 - b) pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim kryerjen normale të detyrave funksionale të sinjalizuesit në UE e jashtë saj;
 - c) pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me UE-në, kur, nga rrethana të bazuara dhe të arsyeshme, sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen nga ILDKPKI-ja.
4. Çdo rregull ose marrëveshje private, në bazë të së cilës përjashtohen ose kufizohen të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesit, sipas Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, është e pavlefshme. Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj marrëveshjeve të konfidencialitetit.
5. Sinjalizuesi informohet nga UE-ja, në mënyrë të plotë dhe në gjuhë të kuptueshme, për të drejtat dhe mbrojtjen e ofruar nga UE-ja, sipas Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 20

Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organe drejtuese të UE-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - b) shkarkimin nga puna;
 - c) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
 - d) transferimin brenda ose jashtë organizatës;
 - e) uljen në detyrë;
 - f) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
 - g) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
 - h) mosngritjen në detyrë;
 - i) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
 - j) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
 - k) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të UE-së, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, organet drejtuese të UE-së marrin

masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë në përputhje me Ligjin 60/2016.

Neni 21

Dëmshpërblimi në rastin e hakmarrjes

Sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë në gjykatë shpërblim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes, në kuptim Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, sipas Kodit Civil

Neni 22

Afati për vendimarrje dhe kërkesa për mbrojtje

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga UE-ja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohej një afat më i gjatë.
2. Universiteti i Elbasanit, me kërkesë të ILDKPKI-së, duhet të provojë që masat e marra në dëm të të sinjalizuarit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin.
3. Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje përfundon sipas procedurave të caktuara në Ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

KREU VII

MONITORIMI I MEKANIZMIT TË SINJALIZIMIT

Neni 23

Raportimi i njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Njësia përgjegjëse e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve në UE:

- a) zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, duke zbatuar udhëzimet për mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm të dala nga ILDKPKI-ja;
- b) garanton mbrojtjen e sinjalizuesit nga masat hakmarrëse, sipas këtij ligji;
- c) paraqet, jo më vonë se data 15 Janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve tek ILDKPKI-ja.

REKTORI

Prof.dr. Skender TOPI

